



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE**  
**-Këshilli Drejtues-**

---

**V E N D I M**

**Nr.1595, datë 04.05.2011**

**Për**

**“Fillimin e procedimit administrativ për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së interkoneksionit midis sipërmarrësve Albtelecom sh.a. dhe Plus Communication sh.a.”**

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), i përbërë nga:

1. Z. Piro	Xhixho	Kryetar
2. Znj. Alketa	Mukavelati	Anëtar
3. Z. Benon	Paloka	Anëtar
4. Z. Ibsen	Elezi	Anëtar
5. Znj. Zamira	Nurçe	Anëtar

dhe sekretare Znj. Marsida Drushku, në mbledhjen e datës 04.05.2011, sipas procedurës së përcaktuar në ligjin nr. 9918 datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, ligjin nr. 8480, datë 27. 05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike” dhe Rregullores së Brendshme të AKEP-it, shqyrtoi çështjen me objekt:

**Fillimin e procedimit administrativ për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së interkoneksionit midis sipërmarrësve Albtelecom sh.a. dhe Plus Communication sh.a.**

**BAZA LIGJORE:**

1. Neni 49, neni 50 pika 1, dhe neni 60 e vijues, pika të ligjit nr. 9918, datë 19. 05. 2008, “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” (*ligji nr. 9918*);
2. Neni 46, e vijues të ligjit nr. 8485, datë 12.05.1999, “Kodi i Procedurave Administrative” (K.Pr.A);
3. Rregullore nr. 18 “Për procedurat e zgjidhjes se mosmarrëveshjeve”, miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues të AKEP nr. 1296, datë 11.06.2010;
4. Rregullore nr. 19 “Për Aksesin dhe Interkoneksionin”, miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues nr. 1300, datë 14.06.2010 e ndryshuar;
5. Pika 17, e nenit 21, të “Rregullores së Brendshme të AKEP (*Rregullorja e Brendshme*), miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues të ERT-së, Nr. 170, datë 24. 04. 2004, e ndryshuar dhe në fuqi sipas pikës 3 të nenit 138, të ligjit nr. 9918,

## K Ë SHILLI DREJTUES:

Nga shqyrtimi i materialit shkresor, të përbërë nga:

- Shkresa e Albtelecom sh.a., me nr. 2039, datë 21.4.2011, mbi paraqitjen e mosmarrëveshjes me Plus Communication sh.a.
- Shkresa e Plus Communication sh.a., me nr. 189 Prot., datë 30.3.2011, “Përgjigje tuajës nr. 1592 Prot., datë 28.3.2011”;
- Shkresa e Albtelecom sh.a., me nr. 1592, datë 28.03.2011, mbi dërgimin e propozimit të Albtelecom sh.a., për amendim të marrëveshjes së interkonkesionit nr. 2351/10, datë 4.10.2010;

si dhe duke iu referuar diskutimeve në mbledhje mbi çështjen, bazës ligjore të sipërcituar,

### V Ë R E N:

1. Albtelecom sh.a., është regjistruar pranë AKEP në regjistrin e sipërmarrësve me nr. 66, për ofrimin e rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike;
2. Plus Communication sh.a., është regjistruar pranë AKEP në regjistrin e sipërmarrësve me nr. 135, për ofrimin e rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike;
3. Ankimi administrativ i paraqitur nga sipërmarrësi Albtelecom sh.a., me shkresën nr. 2039 Prot., datë 21.04.2011, është në përputhje me:
  - Pikën 1, të nenit 50, të ligjit nr. 9918, datë 19.05.2008, “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, si dhe,
  - Rregulloren nr. 18, datë 11.06.2010, “Për procedurat e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve” miratuar me VKD nr. 1296 datë 11.06.2010;
4. Albtelecom, sa më sipër sqaron se, me shkresën nr. 1592 Prot., datë 28.3.2011, në referencë me dokumentet e publikuar nga AKEP:
  - Vendimi nr. 1469, datë 24.12.2010, për “Miratimin për këshillim publik i dokumentit: Orientimi në kosto i tarifave të shërbimeve të operatorëve celularë me FNT”;
  - Vendimi nr. 1505, datë 10.2.2011, për “Miratimin e Dokumentacionit Final për Orientimin në kosto të tarifave të shërbimeve të operatorëve celularë me FNT”,  
i dërgon sipërmarrësit Plus Communication sh.a., Amandamentin nr. 2, të Marrëveshjes së Interkoneksionit nr. 2351/10, datë 4.10.2010, të nënshkruar mes palëve;
5. Albtelecom vlerëson se, mospranimi nga ana e Plus për aplikimin e tarifave të terminimit në rrjetin e tij sipas vlerave të paraqitura në Vendimin nr. 1505 në përputhje të plotë me parimin e trajtimit të përshkallëzuar të tarifës së terminimit në rrjetin e Plus në kuadër të ndryshimeve rregullatore për operatorët celularë, ndikon në reduktimin e të ardhurave për Albtelecom si rrjedhojë e aplikimit të tarifës 18.9 lek/min për terminimin e rrjetit në Plus.

6. Gjithashtu Albtelecom thekson se, diferenca e krijuar nga shuma e të ardhurave nga terminimi në Plus bazuar në tarifën aktuale të terminimit 18.9 lek/min, me tarifën 15.93 lek/min në zbatim të Vendimit nr. 1505 datë 10.02.2011, do të përbënte humbje për Albtelecom dhe një subvencionim të pajustificuar për Plus nga ana e Albtelecom dhe të gjithë operatorëve të tjerë të rrjeteve të komunikimeve elektronike;
7. Për sa më sipër, Albtelecom kërkon që AKEP të marrë Vendim për detyrimin e Plus të zbatojë tarifatat e paraqitura në Vendimin nr. 1505, datë 10.02.2011 “Miratimin e Dokumentacionit Final për Orientimin në kosto të tarifave të shërbimeve të operatorëve celularë me FNT”, për terminimin në rrjetin e Plus;
8. Plus me shkresën nr. 189 Prot., datë 1.4.2011, “Përgjigje tuajës nr. 1592, datë 28.3.2011”, mbi amendimin e MI, dërguar Albtelecom sh.a., sqaron se:
  - a) Vendimi nr. 1505, datë 10.2.2011, për “Miratimin e Dokumentacionit Final për Orientimin në kosto të tarifave të shërbimeve të operatorëve celularë me FNT”, i referohet operatorëve celularë AMC, Vodafone dhe Eagle Mobile të përcaktuar me FNT nga AKEP me vendimet nr. 1210, nr. 1211, nr. 1212, datë 31.3.2010 të ndryshuar, duke pretenduar se:
    - Plus, nuk gëzon statusin FNT, në këtë kuadër përjashtohet nga detyrimi për zbatimin e vendimit nr. 1505, datë 10.2.2011;
    - Në vendimin e lartpërmendur AKEP, shpreh qartë qëndrimin e tij për tarifën e terminimit në rrjetin e Plus, sipas të cilit Plus i përcaktohen vetëm tarifa orientuese dhe rekomanduese, deri në momentin që AKEP do të dalë me një vendim zyrtar për statusin e këtij operatori;
  - b) Çdo amendim marrëveshjeje, bazohet mbi qëndrime aprovuese mes palëve apo ndonjë detyrim ligjor, për të dyja ose njërin nga palët nënshkruese. Në rastin konkret, nuk ndodhemi para ketyre kushteve. Ndërmjet Plus dhe Albtelecom, nuk ekzistojnë qëndrime aprovuese të departamenteve përkatëse për nënshkrimin e një amendamenti;
  - c) Plus, me dërgimin e amendamentit të nënshkruar nga Albtelecom, ndodhet përpara një veprimi imponues të njëanshëm, për të cilin palët as kanë komunikuar dhe as negociuar;
  - d) Gjithashtu, Plus bën me dije se në mungesë të një baze ligjore të karakterit rregullator, kërkesa e Albtelecom për amendim të Marrëveshjes së Interkonkesionit, për tarifën e terminimit në Plus, nuk do të konsiderohet;
9. Sipërmarrësit Albtelecom sh.a. dhe Plus Communication sh.a., megjithë përpjekjet e bëra, nuk kanë arritur të bien dakord në lidhje me tarifën e terminimit në rrjetin e Plus Communication sh.a. AKEP në zbatim të nenit 50, të Ligjit nr. 9918, datë 19.05.2008, *zgjidhja e mosmarrëveshjes mund të kryhet në bazë të kërkesës së një sipërmarrësi apo me iniciativën e AKEP,*

### **P Ë R K Ë T O A R S Y E:**

Bazuar në pikën 1 të nenit 114 dhe pikën 1 të nenit 115, të ligjit nr. 9918, nenin 46 e vijues të K.Pr.A, si dhe pikën 17 të nenit 21 të Rregullores së Brendshme,

## V E N D O S:

1. Të fillojë procedimim administrativ, për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së interkoneksionit midis sipërmarrësve Altelecom sh.a. dhe Plus Communication sh.a;
  2. Të ngrihet komisioni për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve me përbërje si:
    - Altin Rrapaj Kryetar
    - Jonida Gjika Anëtar
    - Përparim Buçaj Anëtar
    - Ded Jakaj Anëtar
    - Florida Çela Anëtar
  3. Të njoftohen palët e interesuara Altelecom sh.a. dhe Plus Communication sh.a për fillimin e procedimit administrativ;
  4. Palët të depozitojnë pretendimet e tyre me shkrim brenda 15 ditëve nga marrja e njoftimit të vendimit;
  5. Ky Vendim të publikohet në faqen e internetit të AKEP: [www.akep.al](http://www.akep.al)
- Ky Vendim hyn në fuqi në datën e miratimit të tij.

**K R Y E T A R I**  
**Piro XHIXHO**

### ANËTARË:

1. **Alketa MUKAVELATI**
2. **Benon PALOKA**
3. **Ibsen ELEZI**
4. **Zamira NURÇE**